

Vendim nr. 314, datë 03.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 03.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (S) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SUZANA ISUFAJ, përfaqësuar nga avokat Jetnor Maxhari, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3139 akti, datë 20.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 672, datë 15.05.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1544, datë 19.09.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja dhe shtetasit M.Sh. e H.Ç. kanë paraqitur një kallëzim penal kundër shtetasës N.N., duke pretenduar se ajo, në cilësinë e drejtueses së Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH), ka lëshuar dokumente (notë transkriptimi nr. 37/19, datë 23.09.1929 dhe shkresë nr. 2364/2, datë 14.06.2010) që përmbanin të dhëna të tjetërsuara, duke nxjerrë disa shtetas, në mënyrë fiktive, si pronarë të pronave të cilat ata (kallëzuesit) i trashëgonin nga shtetasi H.Ç. Mbi këtë kallëzim, në datën 07.12.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*), ka regjistruar një procedim penal (procedimi penal nr. 9524/2016) për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP).

2. Nga hetimi ka rezultuar se për falsitetin e dokumentit notë transkriptimi nr. 37/19, datë 23.09.1929, kërkuesja kishte paraqitur edhe më herët, në vitin 2013, një kallëzim penal, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (*Prokuroria e Sarandës*) kishte regjistruar një procedim penal (procedimi penal nr. 3/2013). Nisur nga kjo, Prokuroria e Tiranës ka administruar kopje të akteve këtij procedimi penal, nga përmbajtja e të cilave është konstatuar se gjatë një procesi gjyqësor civil që zhvillohej mes kërkueses dhe palëve të tjera, që pretendonin të drejta pronësie për të njëjtën pronë, janë futur si ndërhyrës kryesorë shtetasit Th.J. dhe K.J., të cilët, në funksion të së drejtës së pretenduar të pronësisë për atë pronë, kanë paraqitur edhe notën e transkriptimit në fjalë, për përdorimin e të cilit, në vijim, kërkuesja ka paraqitur kallëzim penal ndaj atyre shtetasve. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Sarandës ka vendosur pushimin e procedimit penal, vendim i cili, pas ankimit, është shfuqizuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Në vijim të hetimeve, Prokuroria e Sarandës nuk ka mundur të gjejë kopje të dytë të notës së transkriptimit, por nga modelet e kohës dhe krahasimet e nënshkrimeve të punonjësve që kanë nënshkruar akte me interes për procedimin, nuk janë konstatuar ndërhyrje në dokumentin e pretenduar si të falsifikuar. Po kështu, me interes për hetimin, në AQSH është gjetur një dokument i emërtuar “Lista qi përmban pasunin e patundshme të bleme prej N.J.”, nga përmbajtja e të cilit ka rezultuar se gjente referim edhe nota e transkriptimit në fjalë. Mbi këtë bazë, pasi ka kryer të gjitha verifikimet e nevojshme në AQSH, në përmbushje të detyrave të lëna nga Prokuroria e Përgjithshme, me vendimin e datës 31.10.2016, Prokuroria e Sarandës ka vendosur pushimin e procedimit penal.

3. Në funksion të hetimit të procedimit penal, Prokuroria e Tiranës ka marrë deklaratimet e kallëzuesve dhe të disa shtetasve të tjerë. Po kështu, ajo ka administruar në AQSH kopje të praktikave dokumentare të viteve 2008 dhe 2010, kopje të akteve me indikacione arkivore në interes të procedimit penal, si dhe shkresën e AQSH-së nr. 1742/1 prot., datë

21.02.2017, në të cilën saktësohen edhe pretendimet për përmbajtjen e shkresave të dala nga ajo në adresë të institucioneve përkatëse, sipas objektit të kërkimit, dhe që kishin lidhje me hetimin e procedimit penal.

4. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Tiranës ka vlerësuar se pretendimet e kallëzuesve bënin fjalë për të njëjtat fakte dhe rrethana, që janë trajtuar dhe zgjidhur në kuadër të hetimit të procedimit penal, për të cilin Prokuroria e Sarandës ka konkluduar me vendimin e pushimit të datës 31.10.2016. Në këto kushte, me arsyetimin se për sa kohë nuk ka ndonjë fakt ose rrethanë të re dhe në respektim të parimit të sigurisë juridike, Prokuroria e Tiranës i ka kërkuar gjykatës pushimin e procedimit penal.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3139 akti, datë 20.09.2018, ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke vlerësuar se kërkesa e prokurorisë është e drejtë, pasi për të pasur elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” duhet që subjekti i veprës penale të ketë kryer veprime ose mosveprime që bien në kundërshtim me detyrën e tyre të ngarkuar sipas ligjit, çka nuk provohet në rastin konkret. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit, duke pretenduar mungesën e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, si dhe analizë të gabuar të provave dhe fakteve, dhe keqzbatim të ligjit.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 672, datë 15.05.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si të marrë në zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural penal. Ajo e ka gjetur të drejtë argumentin për qenien në rastin konkret përpara të njëjtave fakte dhe rrethana, për të cilat më herët është disponuar për pushimin e procedimit penal, duke vlerësuar si të pabazuar në prova pretendimin e kallëzuesve për kundërligjshmëri në veprimet e të kallëzuarës N.N. Sipas asaj gjykate, pavarësisht hetimeve të zhvilluara nga Prokuroria e Sarandës, Prokuroria e Tiranës ka verifikuar edhe njëherë të gjitha pretendimet e kallëzuesve, duke administruar praktikat shkresore përkatëse dhe pyetur punonjësit e AQSH-së për mënyrën sesi kanë proceduar në trajtimin e praktikave shkresore, të cilat janë nënshkruar më pas nga drejtuesja N.N. e këtij institucioni. Nga materialet e hetimit paraprak, shprehet ajo, rezulton se shkresa e nënshkruar nga shtetasja N.N. përmban thjesht tregues arkivorë ose, e thënë ndryshe, përcakton koordinatat e vendndodhjes së dokumentit në arkivë, veprime të cilat janë në kompetencë të punonjësve të këtij institucioni dhe në përmbajtjen e të cilave nuk konstatohet asnjë shkelje, e cila të passjell përgjegjësi penale. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-1544, datë 19.09.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se ai

nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

8. Kërkuësja në datën 25.09.2025 (*data e shërbimit postar*) i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuësjes

9. *Kërkuësja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial*, pasi:

- 9.1. Prokuroria e Tiranës ka bërë regjistrim të gabuar të veprës penale, ndërsa ajo duhej të regjistrohej sipas nenit 186, pika 3, të KP-së. Po kështu, procedimi penal është regjistruar pa emër të autorit, megjithëse në kallëzim ai identifikohet. Hetimi ka zgjatur 2 vjet, por nuk është hetuar as objekti i kallëzimit dhe as autorët e mundshëm.
- 9.2. Prokuroria dhe gjykatat, nën parimin e sigurisë juridike, kanë legjitimuar vjedhjen e pronës me dokumente të falsifikuara. Ato nuk kanë hetuar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pyetjes se përse shteti ia konfiskoi pronën trashëgimlënësit të saj H.Ç. dhe pronarëve të tjerë të ligjshëm në vitin 1951 dhe jo personave të tjerë. Është detyrë e gjykatave të verifikojnë ligjshmërinë e provave të pronësisë, duke pasur ndikim në proces edhe mosmarrja e tyre.
- 9.3. Gjykata e Lartë, ndonëse i pasqyron në vendim pretendimet e saj në kallëzim dhe në rekurs, nuk i analizon dhe as argumenton nëse ato qëndrojnë ose jo. Duke vepruar në këtë mënyrë, ajo gjykatë ka cenuar edhe *parimin e paanshmërisë*.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësjes

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi

kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se kërkuësja ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal, të përmbyllur në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, që ka vendosur pushimin e procedimit penal të regjistruar edhe mbi kallëzimin e saj, me pretendimin se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuësja e justifikon interesin e saj në çështjen e parashtruar, në kushtet kur ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

12. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuësja duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real. Nisur nga kjo, duke mbajtur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, në vijim Kolegji do të verifikojë, së pari, se cila e drejtë kushtetuese substanciale e kërkuëses vihet në diskutim në këtë rast dhe, në vijim, nëse vendimet e kundërshtuara të gjykatave janë ato që kanë ose mund të sjellin pasojat negative për atë të drejtë. Në këtë mënyrë do të arrihet në një përfundim nëse kërkuësja ka statusin e viktimës në raport me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, për rrjedhojë nëse ajo legjitimohet *ratione personae* për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

13. Në rastin konkret Kolegji vëren se kërkuësja ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur pushimi i procedimit penal dhe, në këtë kuptim, mosndjekja penale e zyrtarit publik të kallëzuar prej saj. Në thelb, ajo ka kundërshtuar moskryerjen e hetimeve të plota në drejtim të përcaktimit të fakteve që kanë lidhje me të drejtën e pronësisë së trashëgimlënësit të saj përpara datës 29.11.1944. Në lidhje me këtë, gjykatat e zakonshme

kanë arritur në përfundimin se organi i prokurorisë, në kuadër të hetimit penal në lidhje me përmbushjen e rregullt të detyrës nga zyrtari publik i kallëzuar në rastin e lëshimit të dokumenteve që përmbajnë të dhëna në lidhje me të drejtën e pronës, ka kryer hetime të plota dhe nga të dhënat që rezultojnë nga provat e mbledhura nuk provohet se, ai ose punonjës të tjerë të atij institucioni publik, të kenë vepruar në mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke lëshuar dokumente me përmbajtje të pavërtetë, të falsifikuar. Prokuroria dhe gjykatat e zakonshme në asnjë moment nuk kanë hetuar dhe as kanë vënë në diskutim përkatësinë e së drejtës së pronës, për të cilën kërkuesja, sikurse pranon, është në procese gjyqësore civile.

14. Për sa më lart, Kolegji çmon se ndonëse në themel pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me të drejtën e pronës (në thelb me mosgrumbullimin e provave që vërtetojnë mospasjen e së drejtës së pronësisë të kundërshtarëve të saj), kjo e drejtë nuk lidhet drejtpërdrejt me procesin penal të vënë në lëvizje nëpërmjet kallëzimit kundër një zyrtari publik, proces i cili eventualisht përcakton përgjegjësinë penale të atij zyrtari ose të punonjësve të tjerë të atij institucioni publik. Në rrethanat e rastit konkret, procesi penal duket se nuk mund të sjellë pasojat materiale që kërkuesja synon, përveçse ky proces as nuk e kushtëzon atë në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale (civile) që ajo pretendon se i janë shkelur. Nën këtë optikë, procesi gjyqësor penal i kundërshtuar në gjykimin kushtetues nuk ndikon në procesin gjyqësor civil për shqyrtimin në themel të mosmarrëveshjes për të drejtën e pronës. Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk garantojnë të drejtën për të filluar ndjekje penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, 2006*).

15. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vetëm fakti i paraqitjes së një kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin substancial të kërkueses në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi gjyqësor i kundërshtuar të kenë sjellë për të pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtën themelore të pronës. Për rrjedhojë, kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.